



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor  
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužilca / Office of the Chief State Prosecutor

# PLANI I PUNËS



2022



# **Prokurori i Shtetit**

Plani i punës për vitin 2022



## Tabela e përbajtjes

Përbledhje ekzekutive.....	4
I. Mandati i Prokurorit të Shtetit.....	5
II. Përgjegjësítë e Prokurorit te Shtetit.....	6
III. Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit.....	8
IV. Vlerat.....	10
V. Zbatimi i planit të punës.....	11
VI. Objektivat e Prokurorit të Shtetit.....	12
<i>a. Rritja e efikasitetit kundër korrupsionit, pastrimit te parave, kimeve ekonomike dhe krimit të organizuar.....</i>	13
<i>b. Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve.....</i>	15
<i>c. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me vepër penale.....</i>	18
<i>d. Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, posaçërisht ato nga regjistri PPP.....</i>	20
<i>e. Rritja e efikasitetit në aplikimin e procedurave alternative për zgjedhjen e rasteve penale.....</i>	22
<i>f. Unifikimi i praktikave të punës në institucionin e Prokurorit të Shtetit.....</i>	24
<i>g. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut.....</i>	26
<i>h. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.....</i>	28

## Përbledhje ekzekutive

Prokurori i Shtetit nxjerr Planin yjetor të punës për vitin 2022 për të ushtruar mandatin ligjor dhe për të zbatuar Planin strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024.

Hartimi i këtij plani ka për qëllim funksionimin sa më të mirë dhe sa më efikas, duke u bazuar në përgjegjësitë e parapara në Ligjin për Prokurorin e Shtetit, pastaj në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

Plani i punës për vitin 2022 do të përbajë *pjesën e parë apo pjesën hyrëse*, në të cilën përshtkuhen mandati, përgjegjësitë dhe struktura organizative e Prokurorit të Shtetit, duke përfshirë edhe vizionin dhe misionin e tij.

*Pjesa e dyte* përcakton qartazi objektivat e Prokurorit të Shtetit për vitin 2022, me të cilat synohet avancimi i sistemit të punës, mbikëqyrjes dhe llogaridhëniec në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

*Në pjesën e tretë* janë konkretizuar objektivat në formë tabelare, përmes aktiviteteve, treguesve, bartësve të aktiviteteve dhe afateve kohore për realizimin e tyre.

Zbatimi i këtij plani mundëson përbushjen e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Prokurorit të Shtetit, në mënyrë më efikase dhe më të organizuar dhe përmes një planifikimi të tillë do të zbatohen shumë më lehtë objektivat e parapara.

Me rastin e hartimit të planit janë marrë parasysh edhe sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten si pasoje e resurseve buxhetore dhe kapaciteteve njerëzore.

## I. Mandati i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale.

Funkcionet e Prokurorit të Shtetit ushtrohen në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke siguruar që të gjithë, pa dallim, të kenë trajtim të barabartë para ligjit, pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të aftësive shëndetësore, apo edhe pozitës shoqërore.

Prokurori i Shtetit i kryen përgjegjësitë dhe detyrat e veta, duke u bazuar në standartet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare, duke respektuar plotësisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duke i kryer në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha veprimet hetimore në përputhje me procedurën penale.

## II. Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit

Përgjegjësitet kryesore të Prokurorit të Shtetit përfshijnë:

- ❖ ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe sigurimin e të gjithë personave që do të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- ❖ zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- ❖ sjelljen e ndershme dhe profesionale në jetën personale dhe profesionale, duke u bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe Kodin e etikës profesionale;
- ❖ ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- ❖ mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimateve, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
- ❖ ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimtit, si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- ❖ marrjen e vendimeve për iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- ❖ ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;

- ❖ ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- ❖ bashkëpunimin me Policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera dhe
- ❖ ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

### **III. Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit ka strukturën organizative si në vijim:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, si instanca më e lartë e Prokurorisë së Shtetit, me kompetenca në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përveç mbikëqyrjes dhe monitorimit të punës së prokurorëve të shtetit, ndërmerr edhe veprime juridike për të mbrojtur ligjshmérinë në të gjitha çështjet penale, civile, administrative dhe ekonomike.
- Prokuroria e Apelit, e cila është shkallë e dytë dhe ka kompetencë në tërë territorin e Republikës se Kosovës, me autorizim ligjor për të vepruar dhe përfaqësuar lëndët në Gjykatën e Apelit, si gjykate e shkallës së dytë, e cila vendos për mjetet e rregullta juridike.

#### Prokuroria e Apelit ka këto departamente:

- ✓ Departamentin e Përgjithshëm;
- ✓ Departamentin për të Mitur dhe
- ✓ Departamentin për Krimë të Rënda.
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, si organ prokurorial i specializuar, ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, kompetenca dhe përgjegjësi për të hetuar dhe ndjekur krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PRSK-së.

#### Prokuroria Speciale ka këto departamente:

- ✓ Departamentin e Krimeve të Luftës;
- ✓ Departamentin e Terrorizmit;

- ✓ Departamentin për Krim të Organizuar dhe Krime të Tjera dhe
  - ✓ Departamentin për Korruption dhe Krime Financiare.
- Prokuroritë themelore, të shtrira në territorin e shtatë rajoneve të Kosovës, kanë kompetenca për të zhvilluar hetime dhe ndjekje penale, për të ngritur aktakuza dhe për të përfaqësuar në gjykatat themelore, si gjykata të shkallës së parë.

Prokuroritë themelore kanë këto departamente:

- ✓ Departamentin e Përgjithshëm;
- ✓ Departamentin për të Mitur dhe
- ✓ Departamentin për Krime të Rënda.

## IV. Vlerat

Prokurori i shtetit si institucion i pavarur karakterizohet nga vlerat si në vijim:

Professionalizmi, Bogazitëtëtë pavarësia me pambën  
dhe transparancën

Integriteti dhe etika e lartë

Përafshimëria; përkushtimi dhe objektiviteti në  
traktimin e rasteve penale bazuar në standarde me  
te larta ndërkombëtare

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe përdorimit  
racionali i resurseve

Promovimi i bashkëpunimit me aktoret e tjera të  
shtetit të ligjit



## V. Zbatimi i planit të punës

Plani i punës bazohet në mandatin ligjor dhe në vizionin e Kryeprokurorit të Shtetit për udhëheqjen e këtij institucioni. Realizimi i këtij plani do të bëhet përmes objektivave, të matshme dhe të arritshme, që do të realizohen me aktivitete dhe masa konkrete në përputhje me afatet e caktuara.

Plani parashevë edhe vazhdimin e disa aktiviteteve dhe masave, të cilat kanë filluar në vitin paraprak, zbatimi i të cilave do të vazhdojë edhe këtë vit.

Në përcaktimin e objektivave të këtij plani, Prokurori i Shtetit, krahas mandatit, ka marrë përbazë edhe prioritetet shtetërore, që dalin nga aderimi në mekanizma ndërkombëtarë, siç janë Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim (MSA) apo iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare për luftimin e krimit transnacional.

Prokurori i Shtetit ka përcaktuar disa vepra penale, të cilat do të trajtohen me prioritet gjatë punës në vitin 2022, trajtimi i të cilave ndërlidhet me proceset e fuqizimit të sundimit të ligjit dhe krijimin e ambientit të sigurt për investime të huaja dhe përvanës së proceseve të integrimit evropian.

Format e kriminalitetit që do të kenë me prioritet të lartë janë: korrupzioni, krimet ekonomike, krimi kibernetik, krimi i organizuar, krimet e luftës, krimet në baza gjinore dhe dhuna në familje.

Po ashtu, në fokus do të jenë edhe shtimi dhe trajtimi i rasteve të shenjëstruara nga mekanizmi i Kryeprokurorit të Shtetit, i cili është krijuar para disa viteve.

Prokurori i Shtetit synon fuqizimin e strukturave ekzistuese dhe krijimin e mekanizmave të tjera të nevojshëm, me qëllim të luftimit efikas të këtyre grupeve të veprave penale. Krahas këtyre veprimeve, Prokurori i Shtetit do të zbatojë edhe prioritete që dalin nga dokumentet strategjike kombëtare dhe dokumentet përkatëse të institucionit të Prokurorit të Shtetit.

## VI. Objektivat e Prokurorit të Shtetit


- a. Rritja e efikasitetit në luftimin kundër korruptionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike dhe krimit të organizuar
- b. Menaxhimu efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokuroreve dhe prokuroreve
- c. Ngrija e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me vepër penale
- d. Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, posaçërisht atyre nga regjistri PPP
- e. Rritja e efikasitetit në aplikimin e procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve penale
- f. Unifikimi i praktikave të punës në institucionin e Prokurorit të Shtetit
- g. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut
- h. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë

### **a. Rritja e efikasitetit në luftimin kundër korrupsionit, pastrimit të parave, kimeve ekonomike dhe krimit të organizuar**

Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar që ndër prioritet e veçanta dhe të vazhdueshme për vitin 2022 të jetë edhe hetimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave penale, që ndërlidhen me detyrën zyrtare, konkretisht me korrupsionin, pastrimin e parave, krimet ekonomike dhe krimin e organizuar. Prokurori i Shtetit do të ndërmarrë veprime konkrete për ta avancuar dhe fuqizuar dhe më tutje Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe prokuroritë themelore, me theks të veçantë Prokurorinë Themelore të Prishtinës, posaçërisht Njësitin për Luftimin e Kimeve Ekonomike dhe Korruptionit, në mënyrë që të gjitha lëndët e kësaj natyre të trajtohen me prioritet të lartë, profesionalizëm dhe efikasitet.

Gjithashtu, beteja kundër krimit të organizuar si një prej veprave penale që cenon rëndë rendin dhe ligjin në vendin tonë, posaçërisht sigurinë dhe pasurinë e qytetarëve, do të jetë prioriteti ynë dhe në mënyrë të vazhdueshme të nxjerrën para drejtësisë kryesit e këtyre veprave penale, si në fushën e terrorizimit, kimeve të luftës, pastrimit të parave, drogave, veprave penale kibernetike etj.

Trajtimi me prioritet i këtyre veprave penale është kërkesë e vazhdueshme e mekanizmave ndërkombëtarë. Andaj, për të rritur efikasitetin në trajtimin e këtyre rasteve, mbetet objektiv që prokurorët të profilizohen në vazhdimësi dhe trajnohen për të ngritur profesionalizmin në hetimin e këtyre veprave specifike.



## **b. Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve**

Llogaridhënia mbetet një prej elementeve më të rëndësishme për një sistem prokurorial, me ç'rast prokurorët i ndërmarrin veprimet e tyre bazuar në vlerat më të larta që i përkasin një shoqërie, në të cilën mbisundon rendi dhe ligji.

Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar për të avancuar sistemin e mbikëqyrjes së punës të prokurorëve dhe llogaridhënieve për të ngritur vazhdimisht nivelin e cilësisë, profesionalizmit, sjelljes dhe efikasitetit me rastin e trajtimit të rasteve penale.

Veprimet e Kryeprokurorit të Shtetit për ta realizuar këtë objektiv do të realizohen përmes vizitave të rregullta nëpër prokuroritë e Kosovës, me qëllim që të marrë informata sa më të sakta për të dhënë udhëzimet e nevojshëm, që do të ndihmonin realizimin e përgjegjësive ligjore dhe kushtetuese.

Gjatë angazhimit për llogaridhënie sistematike, Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët do të kërkojnë raporte me shkrim në baza të rregullta për të parë ecurinë e trajtimit të rasteve penale, praktikat e përdorura dhe rezultatet e treguara.

Takimet e veçanta dhe kolegjumet do të janë një nga praktikat e mira që do të vazhdojnë për të ngritur dhe për të diskutuar dilemat eventuale të paraqitura, por edhe zgjedhjet e propozuara.


Kryeprokurori i Shtetit ka nxjerrë udhëzime nga fushëveprimitari të ndryshme për të rritur së efikasitetin dhe profesionalizmin e punës së prokurorëve,

si: Udhëzimin për trajtimin e krimeve të urejtjes, për shkatërrimin e të dhënavë të siguruara përmes përgjimit të ligjshëm gjatë hetimeve lidhur me mbrojtjen e burimeve të gazetarisë; për zbatimin, monitorimin, raportimin dhe publikimin e aktivitetave të Prokurorit të Shtetit; për negocimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë; për trajtimin e kallëzimeve penale dhe parashtesave ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve; për dorëzimpranimin e lëndëve në rast të suspendimit – pezullimit nga detyra; për mosdërgim në ndërmjetësim të rasteve të dhunës në familje dhe Udhëzimin për harmonizim të praktikave për kualifikimin juridik të veprës penale "Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit".

Kryeprokurori i Shtetit do të vazhdojë të mbikëqyrë zbatimin e këtyre udhëzimeve dhe do të ndërmarrë veprime atëherë kur paraqitet nevoja me qëllim të rritjes së efikasitetit për transferim të përkohshëm të prokurorëve në prokurori të caktuara.

Në drejtim të kësaj, Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, është menduar të jetë një zotim për profesionalizëm dhe jo plan për ndëshkim.

Respektimi i Kodit të etikës është demonstrim i nivelit më të lartë të profesionalizmit, duke u bazuar në vlerat dhe parimet, si: pavarësia, paanshmëria, integriteti, llogaridhënia, transparenca dhe profesionalizmi i Prokurorit të Shtetit.



### c. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me vepër penale

Prokurori i Shtetit, sa i përket objektivit që ka të bëjë me sekuestrimin e aseteve të fituara përmes veprave penale, synon që të punohet edhe më tej gjatë vitit 2022 në drejtim të rritjes së cilësisë së akteve të prokurorit, në të cilat propozohet sekuestrimi i aseteve të fituara me vepër penale, në mënyrë që rrjedhimisht të këtë rezultate edhe në konfiskimin përfundimtar nga ana e gjykatave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, synohet forcimi i kontrollit sistematik të rasteve të krimeve ekonomike, të cilat rezultojnë me sekuestrim dhe konfiskim. Një qasje e tillë do të vazhdojë edhe këtë vit, në të cilin pritet të avancohet më tutje procesi i mbikëqyrjes, përfshirë udhëzimet për prokurorë, trajnimet dhe raportimet e rregullta, mbi bazën e të cilave janë ndërmarrë masa të nevojshme, duke pasur angazhim të shtuar të hetimeve financiare.


Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale është vazhdimi i punës së Prokurorit të Shtetit, me ç'rast është nxjerrë Udhëzimi në lidhje me kërkesat për konfiskim, ku si rezultat në çdo prokurori janë caktuar koordinatorët për konfiskim të pasurisë.

Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit do të kërkojë aplikimin e shtuar të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Po ashtu, aplikimi i Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale është i domosdoshëm, me ç'rast do të kërcohët angazhim më i madh dhe më proaktiv i kryeprokurorëve dhe prokurorëve, që krahas ngritisës së akteve akuzuese të gjurmohen dhe identifikohen edhe pasuria që dyshohet të jetë fituar me anë të veprave penale.

Prokurori i Shtetit do të angazhohet që Njësiti për Krimë Ekonomike dhe Korrupsion në Prokurorinë Themelore të Prishtinës të plotësohet dhe të profilizohet edhe më tej me prokurorë.

Prokurori i Shtetit do të ketë bashkëpunim të afërt edhe me institucionet e tjera ligjzbatuese për bashkërendimin e aktiviteteve për të pasur rezultate në sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të fituara kundërligjshëm.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet sekuestrimit të pasurisë në rastet e veprave penale, në të cilat janë të përfshirë kryerës të profitit të larte.



## **d. Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, posaçërisht ato nga regjistri PPP**

Efektiviteti i Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e rasteve në vitet e fundit është i dukshëm. Kjo tregohet përmes raporteve vjetore të punës, në të cilat paraqiten përqindja e lartë e rasteve të zgjidhura dhe vendimeve fajësuese të gjykates. Mirëpo, një problem i vazhdueshëm është numri i lartë i lëndëve nga regjistri me kryes të panjohur (PPP).

Statistikisht, ky numër po ndikon negativisht në pasqyrimin real të rezultateve të mira të punës së bëre. Andaj, objektivi kyç i Prokurorit të Shtetit do të jetë zvogëlimi i këtyre lëndëve. Prokurori i Shtetit ka zvogëluar në masë të konsiderueshme lëndët e trashëguara nga ky regjistër, megjithatë, ende mbeten një numër i konsiderueshëm i këtyre lëndëve.

Gjatë vitit 2022, fokusi i Prokurorit te Shtetit do të jetë në zgjidhjen e lëndëve të mbeturë në punë nga vitet paraprake, përmes angazhimit të burimeve njerëzore shtesë (bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë), përfshirë këtu nëse ka nevojë dhe varësisht nga rezultatet edhe prokurorë, përmes transferimeve të përkohshme.

Kryeprokurori i Shtetit do të kërkojë nga prokuroritë themelore dhe PSRK-ja që të hartojnë planet specifike të veprimeve për qasje në zgjidhjen e lëndëve të trashëguara, në veçanti lëndëve me kryes të panjohur dhe atyre me raporte të veçanta.

Prokurori i Shtetit do të vazhdojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ngritjen proaktive të këtij bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe hetimin e kryerësve të panjohur të veprave penale, si dhe parashtrimin e kallëzimeve penale, me qëllim të arritjes së objektivave të parapara në këtë plan.

**Rapoartimet e rengitura - PPP**

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
  - Jo njer-dhjetor



Vlerësimi i gjendjes

Vlerësimi i gjendjes se lendeve në secilën prokurori me kryes të përiqohur (PPP)

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
- Janar-dhjetor



**Hartimi | udhëzuesit**

Hartimi i udhëzuesit me rekomandime për trajtiminë nё stevne me kryes të përiqohur (PPP)

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
- Janar-dhjetor



**Trajtimi | rastevë**

Trajtimi i rastevës ne kryes të përiqohur (PPP) në koordinim me Policia e Kosovës

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
- Janar-dhjetor



**Mobilimi i tё gjitha lendeve ne burimeve njerzore ne trajtimin e kryeve te dhene**

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
- Janar-dhjetor



**Ndryshjen e tё gjitha lendeve qё kanë arritur parashikimin absolut**

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
- Janar-dhjetor



**Monitornimi i punës**

Monitornimi ne vazhdimesi i punës ne kyeprokuroret

- Përgjegjës: ZKPSH-ja, PSRK-ja dhe PTH-të
- Janar-dhjetor



## e. Rritja e efikasitetit në aplikimin e procedurave alternative për zgjidhjen e rasteve penale

Aplikim i procedurave alternative si procedurë e veçantë mundëson zgjidhjen sa më të shpejtë dhe më efektive të rasteve penale dhe palëve lu ofrohet drejtësi me kohë, por edhe mundëson zgjidhje të kënaqshme për palët në procedurën penale.

Kryeprokurori i Shtetit ka vendosur që edhe në planin e punës së këtij viti t'i kushtojë vëmendje më të shtuar aplikimit më efikas të metodave alternative në zgjidhjen e rasteve penale, duke u përqendruar në negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe ndërmjetësimin.

Përdorimi i këtyre metodave mundëson efikasitet dhe efektivitet të procedurës, qasje më të lehtë në drejtësi, ekonomizim të procedurës dhe reduktim të numrit të rasteve në Gjyqësor.


Zgjidhja e rasteve me procedura alternative konsiderohet si një mjet shumë i rëndësishëm që mund ta përdorë prokurori çdo herë kur plotësohen kushtet e parapara me ligj, andaj synimi ynë mbetet rritja e numrit të rasteve të referimit me procedura alternative.

Prokurori i Shtetit, duke e konsideruar si objektiv në vazhdim, ka caktuar zyrtarë të ngarkuar me ndërmjetësim nëpër prokuroritë themelore, mirëpo synohet që të bëhet rekrutimi i zyrtarëve për ndërmjetësim dhe sa i përket aplikimit sa më adekuat të këtyre procedurave kërcohët fuqizimi i komunikimit mes prokurorisë dhe ndërmjetësuesve.

Po ashtu, për ta bërë punën më të qasshme do të ketë monitorim sistematik dhe raportim të rregullt të zgjidhjes së rasteve me procedura alternative.

Rritja e zgjidhjes së rasteve me procedurë alternative do të ndikojë në ekonomizimin e kohës dhe shpenzimeve të tjera në sistemin prokurorial,

por, mbi të gjitha, palet do të marrin drejtësi me kohë dhe pa pasur nevojë për procese të stërvizitës gjyqësore.




## f. Unifikimi i praktikave të punës në institucionin e Prokurorit të Shtetit

Puna e Prokurorit të Shtetit kërkon komunikim dhe koordinim sistematik të brendshëm, ku si pikësynim është unifikimi i praktikave të punës, duke i shmangur dualizmat dhe duke vazhduar monitorimin e punës së prokurorëve nga prokurorët e ZKPSH-së, përgjegjës për secilën prokurori.

Prokurori i Shtetit e parasheh ketë objektiv në plan, duke pasur parasysh që nevojitet një angazhim shtesë për t'i unifikuar praktikat e raportimit të prokurorive, në mënyrë që praktikat e përpilimit të shkresave, akteve dhe formave të përdorura nga prokurorët të jenë unike përderisa ka mundësi, pastaj regjistrimi i lëndëve dhe akteve për mbylljen e rasteve të unifikohen, ashtu siç parashihet me dokumentin e formave të shkresave të hartuara dhe përpiluara në mbështetje edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Prokurori i Shtetit do të ndërmerrë veprime për të monitoruar punën dhe praktikat e përdoruar dhe varësisht nga të gjeturat do të japë udhëzime të qarta se si duhet të veprohet.

Një koordinim në këtë aspekt do të bëhet edhe me Komisionin për Administrimin e Prokurorive, si trup i Këshillit Prokurorial të Kosovës, që, gjithashtu, ka obligim të monitorojë zbatimin e këtyre akteve dhe praktikave.



## g. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut

Prokurori i Shtetit ka avancuar sa i përket transparencës dhe vazhdon ta mbajë të informuar publikun e gjerë për çështjet me interes. Kjo është bërë përmes fuqizimit të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale. Zgjedhja e zyrtarëve për komunikim publik nëpër prokurori dhe hartimi i akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e komunikimit me qytetarët, është indikacion i prekshëm për ngritje të transparencës, përmes ofrimit të qasjes më të lehtë të qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile në informatat e këtij organi kushtetues.


Ngritja e vazhdueshme e transparencës nxjerr në pah nevojën e vazhdimit të aktiviteteve, të cilat e paraqesin transparent institucionin. Gjithashtu, hartimi i politikave të reja të komunikimit është nevojë për ngritjen e transparencës, gjë që nënkupton edhe ngritjen e besueshmërisë.

Prokurori i Shtetit parasheh objektiva, të cilat kanë në fokus realizimin e aktiviteteve të menduara mirë që kanë për qëllim ngritjen e transparencës dhe besimit të qytetarëve në punën tonë.

Ne do të vazhdojmë të avancojmë komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, do të angazhohemi të kemi komunikim proaktiv me mediat dhe shoqërinë civile dhe koordinimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, të parapara për përmirësimin e komunikimit dhe rrityes së transparencës.

Në vitin 2022, Kryeprokurori i Shtetit synon që në pajtim me Rregulloren për shërbimin e komunikim publik në sistemin prokurorial dhe Strategjinë e komunikimit në sistemin prokurorial (2021-2023) të avancojë efikasitetin e mekanizmave të brendshëm për shpërndarjen e informacionit.

Natyrisht, Prokurori i Shtetit duhet të sigurohet që gjatë komunikimit me publikun të sigurojë balancimin në mes të ruajtjes së hetimeve për rastet që është duke i ndjekur penalisht dhe interesit të përgjithshëm për informim të publikut.



## **h. Bashkëpunimi ndërinstiucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë**

Prokurori i Shtetit synon që të avancojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë, me qëllim të realizimit të mandatit ligjor. Krahas këtij bashkëpunimi, Prokurori i Shtetit do të punojë me të gjitha aktorët e drejtësisë dhe organet e tjera shtetërore që të avancojmë më tutje statusin e Prokurorit të Shtetit. Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar dhe përkrahja nga partnerët dhe donatorët është shtyllë e rëndësishme në fuqizimin e punës sonë profesionale dhe të pavarur.

Gjithashtu, Prokurori i Shtetit do të fuqizojë bashkëpunimin ndërkombëtar në aspektin e ndihmës juridike ndërkombëtare dhe përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime dhe forma të tjera të zhvillimit, të organizuara nga forume të ndryshme ndërkombëtare.

Sipas vizionit të Prokurorit të Shtetit, realizimi i këtij bashkëpunimi do të bëhet përmes formave të shkëmbimit të ndërsjellë, vizitave, nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacioneve.

Gjatë viteve paraprake kemi zbatuar politikat e bashkëpunimit profesional dhe proaktiv me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Prokurori i Shtetit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe ka përfituar projekte të ndryshme në vazhdën e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmes të cilave ka fuqizuar koordinimin ndërinstitucional në realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor, me fokus të veçantë në luftimin e dukurive të kundërligjshme.

Prokurori i Shtetit tashmë ka caktuar si përfaqësues një prokuror në të gjitha zyrat prokuroriale, përfshire edhe atë në zyrën e tij, me qëllim të realizimit sa me efikas të bashkëpunimit ndërkombëtar.

